

20080170213

**L I G J**  
**PËR GARANCINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SIPAS MARRËVESHJES PËR**  
**HUA, TË DEDIKUAR PËR PROJEKTIN PËR REFORMA NË HEKURUDHË, E CILA**  
**DO TË LIDHET NDËRMJET HEKURUDHAVE TË MAQEDONISË - TRANSPORTI**  
**SHA - SHKUP DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE**  
**ZHVILLIM**

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve dhe realizimin e dispozitave nga Marrëveshja për hua të dedikuar për Projektin për reforma në hekurudhë, e cila do të lidhet ndërmjet Hekurudhave të Maqedonisë - Transporti SHA - Shkup dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në shumë prej 9 030 000 euro, në afatet dhe kushtet e parapara në Marrëveshjen për hua, nëse Hekurudhat e Maqedonisë - Transporti SHA - Shkup nuk i plotëson dhe servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, do të përcaktohen me Marrëveshjen për hua ndërmjet Hekurudhave të Maqedonisë - Transporti SHA - Shkup dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Neni 3

Të gjitha obligimet të cilat dalin nga Marrëveshja për hua të nenit 1 të këtij ligji, si dhe servisimin e huas do ta kryejë Hekurudhat e Maqedonisë - Transporti AD-Shkup nga të hyrat të cilat i realizon, në afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 4

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 17 vjet, me përfshirje të grejs periudhës prej 5 vjetësh. Shkalla e kamatës sipas së cilës do të servisohet huaja është LIBOR (për valutën euro) plus periudha variabile. Shkalla e kamatës mund të zvogëlohet në bazë të vendimit të marrë paraprakisht të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Huaja do të paguhet në 24 anuitete gjysmëvjetore secila në shumë prej 367 250 euro. Pagesa do të bëhet çdo 15 prill dhe 15 tetor, duke filluar prej 15 prill 2011 deri më 15 tetor 2022.

Në grejs periudhën prej 5 vjetësh, e cila paraqet edhe periudhën e realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë provizion të njëfishtë në shumë prej 1% nga shuma e huas Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe zhvillim. Shuma e provizionit të njëfishtë mund të jetë më e vogël se 1% në bazë të marrjes së vendimit paraprak të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Për shumën e mjeteve të patërhequra nga huaja paguhet provizion në shumë prej 0,75% në vit. Shuma e këtij provizioni mund të jetë më e vogël se 0,75% bazë të marrjes së vendimit paraprak të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Provizioni i mjeteve të patërhequra nga paragrafi 5 i këtij neni paguhet në gjysmëvjetorë dhe atë më 15 prill dhe 15 tetor për çdo vit.

Neni 5

Nëse obligimet e arritura në bazë të kamatës dhe kryegjësë, në afatet e përcaktuara me Marrëveshjen për hua, në emër të Hekurudhave të Maqedonisë - Transporti SHA - Shkup i plotëson Republika e Maqedonisë, Hekurudhat e Maqedonisë - Transporti SHA - Shkup është e

detyruar që në afat prej 30 ditësh nga dita e realizimit të obligimit, të bartë në interes të llogarisë së të hyrave të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, mjete në denarë në shumë të pagesës së ekzekutive, të zmadhuar për kamatën e llogaritur dhe për harxhimet e bëra të lidhura me transaksionin adekuat.

Ministri i Financave ka të drejtë t'i japë urdhëresë Drejtorisë së të Hyrave Publike për bllokimin e mjeteve të Hekurudhave të Maqedonisë - Transporti SHA - Shkup në bazë të kthimit të TVSH-së me qëllim të përmbushjes së obligimeve të arritura ndaj kreditorit, gjegjësisht kompensim shtetit me mjete në denarë në shumën e pagesës së ekzekutive, të zmadhuar për kamatën e llogaritur dhe për harxhimet e bëra të lidhura me transaksionin adekuat.

#### Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, të cilat dalin nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Hekurudhat e Maqedonisë - Transporti AD - Shkup obligohen të lidhin marrëveshje të veçantë.

#### Neni 7

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për garanci i Republikës së Maqedonisë sipas Marrëveshjes për hua, të dedikuar për projektin për reforma në hekurudhë, e cila do të lidhet ndërmjet NP Hekurudhat e Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 109/2005).

#### Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".